



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik **“TOWER” sh.p.k.**, me nr. NIPT-i L21717003H, me administrator Z. Irdi Kulla, me adresë: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Mbikqyrja e punimeve të ndërtimeve dhe rikonstruksioneve të rrjetit të Ujësjetllës Kanalizimeve për UKT sh.a. Faza III.

Loti III: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksion rrjet kanalizimi në rrugën “Siri Kodra” (nga rruga “Ferit Xhajko” deri në rrugën “Besa”)

Fond limit: 1,063,798 (një milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjetllës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja e realizimit të punimeve: 45 ditë duke nisur nga data e fillimit të punimeve.

Data e zhvillimit të tenderit është: 01/07/2016 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.25 të dates 27/06/2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“HE & SK 11” sh.p.k.** NIPT L19008502B
Vlera: **380,600** (treqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH
2. Operatori ekonomik **JV“Ave Consulting” sh.p.k** NIPT K81321002M
& **“Sphaera”sh.p.k.**
Vlera: **638,000** (gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH
3. Operatori ekonomik **“TOWER” sh.p.k.** NIPT L21717003H
Vlera: **873,000** (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“HE & SK 11” sh.p.k.** me nr. NIPT-i L19008502B me administrator Z.Festim Bregasi, me ofertë ekonomike me vlerë prej **380,600** (treqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, është vlerësuar si ofertë ekonomike anomalisht e ulët.

Në këto kushte nëpunësi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me datën 06.07.2016 i ka dërguar mesazh operatorit ekonomik **“HE & SK 11” sh.p.k.** në sistemin elektronik me lëndë “Kërkesë për shpjegime për elementë të veçanta të ofertës”,



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020

Shoqëria “HE & SK 11” sh.p.k. ka kthyer përgjigje në sistemin elektronik, me shkresën Nr.104 Prot. Datë 07.07.2016, dhe me shkresën 15350 Prot. Datë 08.07.2016 me lëndë: “Relacion spjegues për elemente të veçanta të ofertës ekonomike.

KVO ka konstatuar se, në detajimin e ofertës O.E ka paraqitur 4 rubrika:

1. Tarifa sipas kategorisë së punës:	Shuma 1	=	198,000 lekë
2. Kostot e drejtpërdrejta:	Shuma 2	=	90,000 lekë
3. Pagesa Ditore:	Shuma 3	=	34,600 lekë
4. Shpenzime të rimbursueshme:	Shuma 4	=	58,000 lekë
	Shuma Totale	=	380,600 lekë

Në argumentim O.E. nuk ka parashikuar dhe nuk ka paraqitur një normë fitimi.

Gjithashtu në detajim nuk janë paraqitur Shpenzime për shtesat mbi pagë (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që mbulon **punëdhënësi**) 16.7%.

Bazuar në Legjislacionin Shqiptar (në zbatim të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për Mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.7703, date 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 77, datë 28.1.2015 për Kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, etj.)etj.

Punëdhënësi ka detyrimin ligjor të bëjë sigurimin e punëmarësit, me kohë të plotë ose të pjesshme, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute gjatë gjithë kohës, që vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës

- Referuar LigjitNr. 7703, datë 11.05.1993“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.Neni 13Detyrimi për të paguar kontributet

- 1.Kontributet do të paguhen nga personat e siguruar;
2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar **dhe punëdhënësit të tij**, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi;
3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t’i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 9136, datë



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020

11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Shuma 5 = 16.7% x 198,000 = 33,066 lekë

Shuma Totale = 198,000 + 90,000 + 34,600 + 58,000 + 33,066 = 413,666 lekë

Pra shuma totale ndryshon nga vlera e ofertuar nga O.E.

Përfundimi :

- O.E. nuk ka parashikuar Normën e fitimit, ose e ka parashikuar në vlerë 0 (zero), gjë që vë në dyshim cilësinë e shërbimit që do të ofrohet
 - O.E. nuk ka parashikuar në shpenzime detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që mbulon punëdhënësi
2. Bashkimi i operatorëve ekonomik **JV“Ave Consulting” sh.p.k & “Sphaera”sh.p.k.** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 5452 rep. dhe nr.2173 kol., nga shoqëria “Ave Consulting” sh.p.k, me nr. NIPT-i K81321002M, me administrator Z.Arben Dervishaj, me ofertë ekonomike me vlerë prej **638,000** (gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, **si pasojë e tërheqjes së ofertës ekonomike të paraqitur prej tij për këtë objekt prokurimi.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“TOWER” sh.p.k.**, me nr. NIPT-i L21717003H, me administrator Z. Irdi Kulla, me adresë: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P, me ofertë ekonomike me vlerë prej **873,000** (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë)lekë pa TVSH, se është **identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.07.2016.

Ankesa: nuk ka patur